



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-A REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/Delivered	02.12.2021	viti god year	
Organ /Mjesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK 5772/2021			113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.886/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.886/2021 të datës 25.10.2021, të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar nga Avokati Rruga "Ruzhdi Hyseni",nr.22, Vushtrri, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 02.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.886/2021 të datës 25.10.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Policinë e Kosovës sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0197 të datës 27.01.2016, në pozitën "Zyrtar policor" në Policinë e Kosovës i cili përmes kërkesës të datës 20.09.2021 ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë që ti paguhet shtesa prej 200 euro ashtu siç parashifet me Vendimin e Qeverisë Nr.02/39, të datës 01.10.2008.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me vendimin e datës 01.10.2021 me nr.07/1-01/0133 e refuzuan kërkesën e ankuesit. Ankuesi z. me datën 25.10.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5162/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmesë avokatit i cili kërkon që të anulohet vendimin e datës 01.10.2021 me nr.07/1-01/0133.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.10.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës me datën 08.11.2021, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/6 të cilët na kanë informuar se ankuesi është zyrtar policor, nuk është nëpunës civil që të ketë të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil, ndërsa në kërkesën e avokatit Policia e Kosovës ja ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se i njëjti me datën 25.11.2013 është caktuar Zyrtar i Teknologjisë Informative dhe sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.02/39 i datës 08.10.2008 i njëjti merre shtesën prej 100 euro.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 25.10.2021 me numër protokolli 5162/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0197 të datës 27.01.2016; Çertifikatat e datës 01.09.2015; Trajnim i datës 25-27.02.2014 i zhvilluar në Zagreb, Çertifikatë e datës 15-17.11.2016, Vendimi me nr.01/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimi me nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Aneksi I Lista dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita; Përgjigje në kërkesë e datës 01.10.2021; Memorandum zyrtar i datës 11.09.2013 dhe Përgjigje në ankesë e datës 08.11.2021 nga organi i punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i referuar dëshmitë të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit, konstaton se ankuesi është në marrëdhënie pune në Policinë e Kosovës respektivisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës sipas kontratës së punës me kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0197 të datës 27.01.2016, në pozitën "Zyrtar Policor" i cili kryen detyra të përgjithshme dhe autorizime të Policisë që janë të caktuara në Ligjin për Policinë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*, si dhe duke ju referuar detyrave të punës që kryen ankuesi nga pozita "Zyrtar Policor", konstaton se të punësuarit që kryejnë veprimtari ndihmëse dhe të mirëmbajtjes, në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk i takojnë shërbimit civil respektivisht janë kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës ashtu siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 6 ku theksohet se: *6. Nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.* Andaj, duke marrë parasysh se ankuesi tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për



